

VENDIM
Nr. 265, datë 16.5.2018

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN
NR. 175, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË
DHE SHITESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE MËSIMORË NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 107/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në lidhjen nr. 1, që përmendet në pikën 2, bëhen këto shtesa:

i) në numrin rendor 15, pas emërtesës “Psikolog shkolle” shtohet emërtesa “Mësues i praktikës profesionale”;

ii) në numrin rendor 22, pas emërtesës “Mësues në ciklin e ulët, në shkollat 9-vjeçare” shtohet emërtesa “Instruktur i praktikës profesionale”.

b) Në lidhjen nr. 2, që përmendet në pikën 3/a, bëhen këto shtesa:

i) Në kolonën e dytë, që i përket grupit 3, shtohet paragrafi, si më poshtë si vijon:

“Personeli instruktur i praktikës profesionale, i punësuar me kontratë të përhershme dhe që ka mbaruar një shkollë të mesme të profilizuar.”.

ii) Në kolonën e tretë, “Niveli i diplomës”, që i përket grupit 3, shtohet paragrafi, si më poshtë si vijon: “Diplomë e shkollës së mesme profesionale.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2018, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi